

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Marshi për Liri". Mbahet tubimi në Prishtinë, mijëra qytetarë mblidhen në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së
ADRESA	https://kohajone.com/kosova/marshi-per-liri-mbahet-tubimi-ne-prishtine-mijera-qytetare-m-blidhen-ne-mbeshtetje-te-ish-krereve-te-uck-se/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 12:52:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 12:52:10 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	292908b46eeebef60d043d8825c8bbddb9dc30654e72c6a0d6a2e561adcd26a
TEKSTI	49b4f42ff6640f8af1d64f33fb9af5649eee9cb9df3146b5c37a5844af2b5656
PAMJA	62bf3a1d7c7b241612e1163b9800694e81bc4c5ba2722bfa922d8acf46cdfa35

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	178a6d682bc3fe753913a3d6d38a6c0db829fb128c3e9fdac93807962caf2237
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	970cd37a1614dea6f0873e85d48db8f576e35cd01413e9c802b6a3c40ac74820
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/178a6d682bc3fe753913a3d6d38a6c0db829fb128c3e9fdac93807962caf2237>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


“Marshi për Liri”. Mbahet tubimi në Prishtinë, mijëra qytetarë mbledhen në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së

AKTUALITET KOSOVA E SHTUNË, 12 SHTATOR 2026 14:52



Po mbahet në Prishtinë tubimi në mbështetje të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në prag të shpalljes së aktgjykimit nga Dhomat e Specializuara në Hagë.

Mijëra qytetarë janë mbledhur në sheshin “Skënderbeu”, duke iu bashkuar “Marshit për Liri”, të organizuar nga iniciativa “Liria ka emër”. Tubimi zhvillohet në shenjë solidariteti me Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin.



Endrit Thaçi, djali i ish-presidentit Hashim Thaçi, ka mbërritur në marsh, i shoqëruar nga deputeti i PS-së, Taulant Balla.



Pjesë e tubimit janë qytetarë nga qytete të ndryshme të Kosovës, ndërsa në Prishtinë kanë mbërritur edhe shqiptarë nga Shqipëria dhe diaspora. Dhjetëra qytetarë nga Shqipëria kanë kaluar përmes pikës kufitare të Morinit, ndërsa mes pjesëmarrësve janë edhe shqiptarë nga Zvicra dhe vende të tjera.

Tubimi zhvillohet në prag të vendimit të shkallës së parë për katër ish-krerët e UÇK-së, i cili pritet të shpallet më 16 shtator në Hagë.

Sakaq, Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca janë gjithashtu të pranishme në sheshin “Skënderbeu”, në mbështetje të “Marshit për Liri”. Pjesëmarrës është edhe kreu i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti.

Vetëvendosje gjithashtu merr pjesë në marsh. Deputeti Arton Konushevc, vëllai i dëshmorit Ilir Konushevc, dhe deputetët Adnan Rrustemi, Valon Hoti e Salih Zyba janë të pranishëm mes qytetarëve.

LAJMET KRYESORE



Rama paralajmëron drejtuesit e administratës: Çdo shkelje afati për kërkesat e qytetarëve duhet të ketë përgjegjësin dhe koston e vet



Kreu i Policisë tregon masat për nisjen e vitit të ri shkollor: Kamera inteligjente dhe kontrolle për drogën e sigurinë ushqimore



Dea e Butrintit rikthehet në shtëpi (video)



Moti sot, 12 shtator 2026: Vranësira, reshje shiu dhe stuhi të izoluara



Gjergj Luca: “Ja dolëm!”, zëri kushtrues i një ëndrrë që u bë qytet

TË PËRZGJEDHURA



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve



Dëshirat e Spalletit dhe blerjet e Juventus-it



Tesla, drejtimi gjysmë-autonom drejt përshtatjes me rregullat evropiane, thotë Franca



Shpërthen Erion Braçe te Nikoll Lesi në KOHA JONË-DEBAT: Nuk votoj kandidat me “njoftim”!

MË TË LEXUARAT

Për mbarrëvajtjen e aktivitetit, Policia e Kosovës ka marrë masa në qarkullim, ndërsa janë bllokuar përkohësisht rrugët "Agim Ramadani", "Luan Haradinaj" dhe "Enver Zymberi".

Organizatorët kanë bërë të ditur gjithashtu se është siguruar transport falas nga qytetet e Kosovës për qytetarët që dëshirojnë t'i bashkohen marshimit. Në Prishtinë, gjatë ditës së sotme, transporti publik dhe parkingjet janë pa pagesë.

MË SHUMË NGA AKTUALITETI



Rama paralajmëron drejtuesit e administratës: Çdo shkelje afati për k...

Emigrantët sjellin më shumë para. Banka e Shqipërisë: 621 milionë eur...

Rritet çmimi i naftës dhe i benzinës në vend



Ra në kontakt me energjinë gjatë riparimit të linjës elektrike, humb ...



Arrestohet në Athinë i shumëkërkuari shqiptar, Hita jep detajet



Aksident në Tiranë, autobusi i linjës së Linzës përplasat me një makinë

LAJMET E FUNDIT



Rama paralajmëron drejtuesit e administratës: Çdo shkelje afati për kërkesat e qytetarëve duhet të ketë përgjegjësin ...

[19 MINUTA MË PARË](#)

Emigrantët sjellin më shumë para. Banka e Shqipërisë: 621 milionë euro në 6 muaj

[39 MINUTA MË PARË](#)

Rritet çmimi i naftës dhe i benzinës në vend

[1 ORË E 3 MINUTA MË PARË](#)



Vendimi për ish-krerët e UÇK në Hagë, reagon BE: Vendet ta respektojnë. 16 shtatori nuk është fundi i gjyqit

[1 ORË E 26 MINUTA MË PARË](#)



SHBA zyrtarizon huanë 302 milionë dollarë për Shqipërinë, ministri Nufi: Partneritet strategjik

[2 ORË E 6 MINUTA MË PARË](#)



Berisha takon kongresmenin Gooden: Drejtësi e pavarur dhe luftë kundër karteleve të drogës

[2 ORË E 9 MINUTA MË PARË](#)

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: **Nikoll LESI**

KRYEREDAKTOR: **Daniel MUÇAKU**

ZV/KRYEREDAKTOR: **Redjon SHTYLLA**

BORDI: **Elsa KAMBERI**, KRYETARE

NIPT: **J71425013C**



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.